- 13.8 L'Assemblea dei soci delibera, per qualsiasi materia, con il voto favorevole dei soci rappresentanti almeno i $\frac{3}{4}$ (tre quarti) dei soci presenti che rappresentano almeno il 51% (cinquanta uno per cento) dell'intero capitale sociale.
- 13.9 Ogni Assemblea è presieduta da un socio o altra persona designata dalla stessa Assemblea. Per la verbalizzazione, l'Assemblea nomina un Segretario, anche non socio.
- 13.10 Le deliberazioni e/o verbali dell'Assemblea devono essere sottoscritte dal Presidente dell'Assemblea e dal Segretario.

Art. 14 – Amministrazione

- 14.1 La Società è amministrata da uno o più Amministratori con poteri congiunti o disgiunti. Gli Amministratori, se non diversamente stabilito dall'Assemblea, rimangono in carica per un termine di 3 (tre) anni ovvero fino a revoca o dimissioni e sono rieleggibili.
- 14.2 La rappresentanza legale della Società spetta all'Amministratore unico o agli Amministratori, congiuntamente o disgiuntamente, il quale/i quali potrà/potranno esercitare tutti i poteri in conformità con quanto previsto dall'articolo 95 della legge n. 9901 del 14.04.2008 "Per i Commercialisti e le Società Commerciali" ed in ogni caso nel rispetto dei limiti stabiliti nel loro atto di nomina e/o nel presente Statuto.
- 14.3 L'Amministratore può nominare procuratori speciali per singoli atti o categorie di atti.

Art. 15- Esperto contabile autorizzato

- 15.1 Qualora richiesto dalla legge o deliberato dall'Assemblea dei soci, il controllo dei prospetti contabili d'esercizio e dei libri contabili della società sarà affidato ad uno o più esperti contabili autorizzati.
- 15.2 L'esperto contabile autorizzato può essere nominato e revocato in ogni momento secondo le modalità previste dalla legislazione in vigore.

CAPITOLO IV ANNO FINANZIARIO, BILANCIO ANNUALE, DISTRIBUZIONE DEGLI UTILI

Art. 16 - Anno finanziario e dei prospetti contabili annuali

- 16.1 L'anno finanziario inizia il 1° gennaio e termina il 31 dicembre.
- 16.2 Il primo anno finanziario inizia alla data di registrazione della Società presso il Centro Nazionale di Registrazione e termina il 31 dicembre dello stesso anno.
- 16.3 I bilanci annuali, l'inventario, la relazione dell'Amministratore ed eventualmente dell'esperto contabile nominato vengono approvati secondo la maggioranza prevista nell'art. 13.8 del presente Statuto.
- 16.4 L'approvazione dei documenti relativi all'esercizio annuale avverrà entro 6 (sei) mesi dalla fine dell'anno finanziario.

Art. 17 – Utili

- 17.1 Gli utili netti risultanti dal bilancio annuale sono distribuiti ai soci in proporzione alle quote del capitale sociale rispettivamente possedute.



6

- 17.2 L'Assemblea potrà deliberare la destinazione degli utili a favore di riserve straordinarie o per altre destinazioni oppure il rinvio della distribuzione degli utili - in tutto od in parte - ai successivi esercizi.

CAPITOLO V SCIoglimento E LIQUIDAZIONE DELLA SOCIETÀ

Art. 18 - Scioglimento

- 18.1 La Società si scioglie alla scadenza del termine di durata prevista nello statuto oppure prima di tale scadenza nei casi previsti dalla legge o per decisione dell'Assemblea dei soci, con la maggioranza prevista per la modifica dello statuto della Società.
- 18.2 La Società non si scioglie in caso di incapacità o fallimento dei soci. In caso di morte del socio valgono le norme di legge.

Art. 19 - Liquidazione

- 19.1 Nel caso di scioglimento la Società verrà posta in liquidazione.
- 19.2 Per gestire questa procedura l'Assemblea dei soci nominerà uno o più liquidatori i quali presenteranno un bilancio della situazione della società al momento dell'apertura della procedura di liquidazione.
- 19.3 Al termine della procedura di liquidazione l'Assemblea dei soci deciderà sul bilancio finanziario definitivo, sulla validità del lavoro svolto dal liquidatore e sulla fine dell'operazione di liquidazione.
- 19.4 Dopo il pagamento dei creditori e la riscossione delle istanze di incasso, il liquidatore/i distribuirà i proventi finali della liquidazione ai soci in proporzione alle quote da essi rispettivamente detenute nel capitale sociale.

Art. 20 - Composizione delle controversie

- 20.1 Tutte le controversie che dovessero insorgere circa la interpretazione, applicazione e risoluzione del presente statuto e dell'atto costitutivo della società nonché in genere quelle che dovessero insorgere tra i soci (tranne quelle inerenti a rapporti personali od extra societari) oppure tra uno o più soci e la società verranno in linea di principio amichevolmente e direttamente discusse tra gli interessati.
- 20.2 In caso di mancata composizione in via amichevole, la soluzione sarà affidata al Tribunale di Tirana.

Articolo 21 - Lingua


- 21.1 Il presente Statuto è redatto in 3 (tre) copie in lingua albanese con annessa la traduzione in lingua italiana.
- 21.2 Per tutte le controversie che dovessero insorgere relativamente all'interpretazione dei predetti atti e documenti, la versione albanese sarà l'unica legalmente vincolante.

SOCI

per la società "Eltex" S.r.l.

sig. Ilir Myftaraj


Rappresentata dal sig. **ELTEK** SRL
Via Otrina Piambeo, 26
33084 CORDENONS (PN)
P.IVA / C.F. 01130470531



Interprete





STATUTI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
ILLYRIATEK Sh.p.k.

Sot më datë 04.12.2023, në Tiranë, palët e mëposhtme:

- **Shoqëria "Eltek" S.r.l**, shoqëri me me përgjegjësi të kufizuar e së drejtës italiane, me P.I: 01130470931, me seli ligjore në Cordenons (PN), Via Chiavornicco, n. 26, Itali, e përfaqësuar nga z. Andrea Bianchet, qytetar italian, lindur në Pordenone (PN), Itali, më 04.04.1982, me vendbanim në Pordenone (PN), Itali, mbajtës i pasaportës italiane me nr. YB2286825, sipas Vendimit të Këshillit Administrativ të shoqërisë datë 26.09.2023, dhe
- **z. Ilir Myftaraj**, qytetar shqiptar, i lindur më 15.02.1969, në Elbasan, Shqipëri, me vendbanim në Lagja Shenkoll, pall. 110/2, apt. 12, Elbasan, Shqipëri, mbajtës i letërnjoftimit shqiptar nr. 031831248 me numër personal G90215117E

kanë vendosur të nënshkruajnë Statutin e mëposhtëm të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, aktiviteti i së cilës rregullohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi dhe nga ky Statut.

KAPITULLI I
FORMA, EMËRTIMI, OBJEKTI, SELIA, KOHËZGJATJA

Neni 1 – Forma

- 1.1 Shoqëria ILLYRIATEK Sh.p.k. (në vijim "**Shoqëria**") krijohet në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, dhe veprimtaria e saj rregullohet me anë të këtij Statuti dhe Aktit të Themelimit.
- 1.2 Shoqëria vepron sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.
- 1.3 Akti i Themelimit dhe Statuti janë në përputhje me legjislacionin shqiptar që ka karakter të detyrueshëm, ndërsa çështjet që nuk janë shprehimisht të parashikuara në to, plotësohen nga legjislacioni shqiptar.

Neni 2 – Emërtimi

Emërtimi i Shoqërisë është ILLYRIATEK Sh.p.k.

Neni 3 – Objekti i shoqërisë

- 3.1 Shoqëria ka për objekt kryerjen e aktiviteteve tregtare në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.
- 3.2 Në mënyrë më specifike, Shoqëria ka për objekt: montime e punime elektrike e mekanike, elektronike të çdo lloj natyre; përgatitje impiantesh, kuadrosh e kavosh elektrike për makineri të ndryshme; prodhimi i kablllove; import dhe eksporti i tyre; import, eksport, tregtim me shumicë dhe pakicë të artikujve të ndryshëm industrialë, materiale elektroshtepiake, materiale ndërtimi, materiale elektrike, hidraulike, pajisje teknologjike, makineri e agregate të ndryshme. Shoqëria do të kryejë edhe aktivitete transporti dhe logjistike, blerje ose marrje me qira të makinerive, kryerjen e trajnimit të personelit, etj.
- 3.3 Shoqëria mund të kryejë çdo operacion tregtar, operacione që lidhen me pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme dhe hipotekore që lidhen me to, operacione financiare dhe kredimarrje, të japë garanci personale ose me pasuri në favor të të tretëve si edhe të blejë dhe shesë ose marrë me qira ndërmarrje, degë ndërmarrjesh, si edhe të ketë pjesëmarrje në shoqëri, ente, konsociume, bashkime shoqërisht të themeluara apo në themelim e sipër, që kanë objekt të njëjtë ose të ngjashëm me të vetin apo gjithsesi funksional për arritjen e qëllimeve të shoqërisë. Më në përgjithësi, Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër të nevojshëm apo të dobishëm për realizimin e qëllimeve të shoqërisë.



Neni 4 - Selia

- 4.1 Selia e Shoqërisë është në Elbasan, Fshati Hajdaran, zk.1919, pasuria nr.8/102, Shqipëri.
- 4.2 Transferimi i selisë së Shoqërisë në një vend tjetër bëhet me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme.
- 4.3 Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë, hapjen e filialeve, selive dytësore, degëve dhe përfaqësive të Shoqërisë në qytete të tjera të Shqipërisë, dhe jashtë shtetit. Asambleja e Përgjithshme mund t'ia delegojë këtë kompetencë organit administrativ.

Neni 5 - Kohëzgjatja e veprimtarisë

- 5.1 Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë me afat të pacaktuar.
- 5.2 Shoqëria mund të prishet përpara këtij afati ose mund të zgjasë kohëzgjatjen e saj me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të nevojshëm për ndryshimin e statutit.

KAPITULLI II

KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, NDARJA DHE TRANSFERIMI I KUOTAVE

Neni 6 - Kapitali themeltar

- 6.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100 (njëqind) Lekë.
- 6.2 Kapitali themeltar i Shoqërisë përbëhet nga 2 (dy) kuota, të gjitha të nënshkruara dhe me vlerë sipas përcaktimit të nenit 7, të këtij Statuti.

Neni 7 - Kontributet

- 7.1 Kontributi në kapitalin e Shoqërisë do të jetë si më poshtë:
 - shoqëria Eltek S.r.l. do të ofrojë një kontribut në para në shumën prej 50 (pesëdhjetë/00) Lekë në favor të shoqërisë në themelimin e sipër; dhe
 - z. Ilir Myftaraj do të ofrojë një kontribut në para në shumën prej 50 (pesëdhjetë/00) Lekë në favor të shoqërisë në themelimin e sipër.
- 7.2 Sipas kontributeve të mësipërme:
 - shoqërisë Eltek S.r.l. i përket 1 (një) kuotë, që i korrespondon 50% (pesëdhjetë përqind) të kapitalit të Shoqërisë;
 - z. Ilir Myftaraj i përket 1 (një) kuotë, që i korrespondon 50% (pesëdhjetë përqind) të kapitalit të Shoqërisë.

Neni 8 - Rritja e kapitalit themeltar

- 8.1 Kapitali themeltar mund të rritet pa kufi në çdo moment, një ose disa herë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme me shumicën që është e nevojshme për ndryshimin e Statutit. Në rast rritjeje të kapitalit, të gjithë ortakët kanë të drejtën të nënshkruajnë rritjen në raport me vlerën nominale të kuotes së zotëruar.
- 8.2 Ortaket kane detyrim të vendosin menjehere rritjen e kapitalit (nënshkrimin dhe pagimin e tij) nese verifikohet ndonje prej rasteve si ne vijim:
 - 8.2.1 aktivet e Shoqërisë nuk mbulojnë teresisht detyrimet e saj; dhe /ose
 - 8.2.2 Shoqëria nuk ka kapital të mjaftueshëm për të përmbushur detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim; ose
 - 8.2.3 gjendja financiare e Shoqërisë kërkon, sipas dispozitave ligjore, rritjen e kapitalit themeltar për të siguruar që Shoqëria të mos shkojë drejt prishjes sipas ligjit apo falimentimit.
- 8.3 Në rastin e verifikimit të ndonje prej rasteve të parashikuara nga neni 8.2, thirret

menjëherë Asambleja e Përgjithshme e cila emëron, pa asnjë vonesë, një ekspert të fushës i cili do të ketë për detyrë të përcaktojë me shkrim, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga emërimi, verifikimin e ekzistencës së ndonjë prej rasteve të parashikuara nga neni 8.2, dhe nëse është rast vlerën e rritjes së kapitalit të Shoqërisë (ne vijim "Vlera e Rritjes së Kapitalit"), si edhe pjesën përkatëse që duhet të paguajë cdo ortak në raport me kuotën e tij në Shoqëri. Si kriter për përcaktimin e Vlerës së Rritjes së Kapitalit duhet të jetë mbulimi i nevojave të Shoqërisë për mjete likuide për përbalimin e kapitalit punues për 12 deri 24 muaj, si edhe rregullimi i situatës së kapitaleve të veta të Shoqërisë në rastin kur vlera e tyre bëhet një numër negativ. Raporti i ekspertit mbi Vlerën e Rritjes së Kapitalit i dërgohet menjëherë Shoqërisë dhe secilit prej ortakëve të saj.

- 8.4 Me marrjen raportit të ekspertit mbi Vlerën e Rritjes së Kapitalit, thirret menjëherë Asambleja e Përgjithshme e cila, pa asnjë vonesë, vendos për rritjen e kapitalit të Shoqërisë në vlerën jo më pak se vlera e përcaktuar nga eksperti sipas raportit mbi Vlerën e Rritjes së Kapitalit. Asambleja e Përgjithshme vendos (i) vlerën e rritjes së kapitalit që nënshkruhet nga secili ortak; dhe (ii) afatin e pagesës nga secili ortak (në çdo rast jo më vonë se 60 ditë nga vendimi i Asamblesë së Përgjithshme) si edhe dhe modalitetet e pagesës.
- 8.5 Nëse një nga ortakët parashtrohet me shkrim në Asamblesë e Përgjithshme sipas paragrafit 8.4 me lart, pamundësinë e përkohshme për të paguar vlerën e rritjes përkatëse të kapitalit në ngarkim të tij (ne vijim "Ortaku I"), ortakun tjetër (ne vijim "Ortaku II") ka të drejtë që të financojë Ortakun I për jo më shumë se 80% (tetëdhjetë përqind) vlerës së rritjes përkatëse të kapitalit në ngarkim të Ortakut I me kusht që:
- (i) Ortaku I të ketë paguar 20% (njëzet përqind) vlerës së rritjes përkatëse të kapitalit në ngarkim të tij brenda afatit të pagesës sipas vendimit të Asamblesë së Përgjithshme sipas paragrafit 8.4 më lart;
 - (ii) Ortaku I të ketë krijuar dhe regjistruar një barrë sigurorese / peng (sipas zgjedhjes së Ortakut II) mbi kuotën e Ortaku I në Shoqëri për të garantuar financimin e Ortakut II sipas marrëveshjeve përkatëse që do të lidhen midis ortakëve në fjalë;
 - (iii) Ortaku I të angazhohet për kthimin e financimit tek Ortaku II sipas kushteve vijuese:
 - jo më pak se 30% (tridhjetë përqind) të vlerës së financuar t'i kthehet Ortakut II brenda nje afati 1 vjecar nga data e vendimit te Asamblese se Përgjithshme per rritje të kapitalit sipas paragrafit 8.4 më lart;
 - jo më pak se 30% (tridhjetë përqind) të vlerës së financuar t'i kthehet Ortakut II brenda nje afati 2 vjecar nga data e vendimit te Asamblese se Përgjithshme per rritje të kapitalit sipas paragrafit 8.4 më lart;
 - pjesa e mbetur e vlerës së financuar t'i kthehet Ortakut II brenda nje afati 3 vjecar nga data e vendimit te Asamblese se Përgjithshme per rritje të kapitalit sipas paragrafit 8.4 më lart.
 - (iv) vlera e financuar nga Ortaku II të shkojë për llogari të shlyerjes së vlerës së rritjes përkatëse të kapitalit në ngarkim të Ortakut I.
- 8.6 Nuk mund të kryhet asnjë rritje tjetër kapitali nëse kuotat e nënshkruara më parë nuk janë shlyer tërësisht.

Neni 9 – Zvogëlimi i kapitalit themeltar

- 9.1 Shoqëria mund të zvogëlojë kapitalin themeltar me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme me shumicën që është e nevojshme për ndryshimin e Statutit. Në çdo rast kapitali themeltar nuk mund të zvogëlohet nën kufijtë e parashikuar nga ligji.
- 9.2 Zvogëlimi i kapitalit përballohet nga secili prej ortakëve në të njëjtën masë me pjesët e kapitalit të zotëruara prej tyre.

Neni 10 – Transferimi i kuotave

- 10.1 Kuotat janë lirish të transferueshme ndërmjet ortakëve.



3

E drejta e Parablerjes

- 10.2 Në rast transferimi në çdo lloj forme, si me shpërblim ashtu edhe pa shpërblim në kuptimin më të gjerë të fjalës, duke përfshirë këtu edhe dhurimin në favor të subjekteve të tjerë të ndryshëm nga ortakët, kuotat duhet më parë t'i ofrohen në parablerje ortakëve të tjerë, përveç rasti të transferimit në favor të fëmijëve dhe bashkëshortit të ortakut; në këtë rast ortakët e tjerë kanë të drejtë të shprehin pëlqimin e tyre me shkrim për transferimin tek ortakët e rinj.
- 10.3 Në një rast të tillë ortaku që do të transferojë kuotat e tij të kapitalit duhet t'i njoftojë ortakët e tjerë, me letër rekomande me kthim përgjigje (në vijim "**Njoftimi**"), (a) numrin e kuotave të ofruara; (b) emrin e blerësit/përfituesit; (c) çmimin e rënë dakort për çdo kuotë, i përcaktuar në çdo rast në para, ose në vlerën në para në rast të një kundërshpërblimi tjetër të mundshëm (në rast shkëmbimi, kompensimi vullnetar, transaksioni, dhe çdo rast tjetër transferimi me shpërblim), ose vlerën e objektit të transferimit në rastin e transferimit pa shpërblim; (d) modalitetet e pagesës; (e) ftesën për të ushtruar të drejtën e parablerjes. E drejta e parablerjes i referohet të gjitha kuotave të kapitalit ofruar për shitje.
- 10.4 Ortakët do të kenë në dispozicion 30 (tridhjetë) ditë nga marrja e Njoftimit, për t'i komunikuar ortakut që transferon kuotat, synimin e tyre për të ushtruar apo jo të drejtën e parablerjes. Në rast se ata nuk përgjigjen në afatin e caktuar, prezumohet se kanë hequr dorë nga e drejta e tyre e parablerjes.
- 10.5 Në rast se oferta pranohet nga disa ortakë, kuotat e ofruara nga ortaku që transferon kuotat, do të ndahen nga ortakët pranues, në të njëjtën masë me kuotat që ata zotërojnë, përveç rasti kur ka një marrëveshje të kundërt. Në asnjë rast, pranuesi i ofertës nuk mund të ushtrojë pjesërisht të drejtën e parablerjes.
- 10.6 Në rast se nuk ushtrohet e drejta e parablerjes, kuotat e ofruara në njoftim mund t'u transferohen të tretëve sipas çmimit të specifikuar në të.

Të drejtat dhe detyrimet e bashkëshitjes

- 10.7 Nëse një ose më shumë ortakë (në vijim "**Ortakët Transferues**") vendosin të disponojnë, tërësisht ose pjesërisht, kuotat e tyre (më tej "**Kuota e Ofruar**"), në favor të një pale të tretë, ata duhet të garantojnë të drejtën e bashkëshitjes së Ortakëve të mbetur (në vijim "**Ortakët e Mbetur**"). Ortakët Transferues, pa asnjë vonesë, dërgojnë një komunikim me shkrim (në vijim "**Njoftimi i Shitjes**"), në të cilin duhet të jenë të përcaktuara termat dhe kushtet e propozimit të shitjes (përfshirë çmimin e shitjes dhe identitetin e subjektit të tretë blerës i mundshëm) (në vijim "**Personi i Tretë Blerës i Mundshëm**"). Ortakët e Mbetur do të kenë 30 (tridhjetë) ditë (në vijim "**Afati i Bashkëshitjes**") për të njoftuar me shkrim Ortakët Transferues lidhur me synimin për të ushtruar të drejtën e tyre të bashkëshitjes dhe/ose të drejtën e parablerjes (në vijim "**Deklarata e Ushtrimit të së Drejtës së Bashkëshitjes**").
- 10.8 Nëse Ortakët e Mbetur u komunikojnë, Ortakëve Transferues, Deklaratën e tyre të Ushtrimit të së Drejtës së Bashkëshitjes, Ortakët e Mbetur do të kenë të drejtën t'i transferojnë Personit të Tretë Blerës i Mundshëm, siç është identifikuar në Njoftimin e Shitjes, kuotat e tyre në Shoqëri me një çmim dhe kushte identike me ato të Ortakëve Transferues (E Drejta e Bashkëshitjes), dhe në çdo rast me kushte jo më pak të favorshme se ato të përcaktuara në Njoftimin e Shitjes. Në çdo rast, çmimi dhe kushtet e shitjes nuk duhet të jenë më pak të favorshme se ato të cilave do t'i nënshtrohej ortaku në rast të ushtrimit të së drejtës së tij për t'u tërhequr nga Shoqëria.
- 10.9 Kushtet dhe mënyrat e komunikimit të vullnetit për të ushtruar të drejtën e parablerjes të parashikuara nga nenet 10.2-10.5 të Statutit të Shoqërisë zbatohen *mutatis mutandis* për Detyrimin e Bashkëshitjes.


4

**KAPITULLI I
ASAMBLEJA, ADMINISTRATORET DHE EKSPERTI KONTABËL**

Neni 11 – Asambleja e Përgjithshme dhe kompetencat e saj

- 11.1 Organi vendim-marrës i Shoqërisë është Asambleja e Përgjithshme.
- 11.2 Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për çështjet vijuese: ndryshimet e statutit, emërimi e shkarkimi i administratorëve, ekspertëve kontabël e likuidatorëve, zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit, transferimi i kuotave, shpërndarja e fitimeve, riorganizimi dhe prishja e shoqërisë, miratimi i bilancit dhe për çdo vendim tjetër parashikuar nga ky Statut apo nga legjislacioni përkates.

Neni 12 – E drejta e pjesëmarrjes dhe e votës

- 12.1 Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në Asamble, të paraqesë mendimin e tij dhe të japë aq vota, në përpjestim me vlerën e kuotës që ai zotëron në kapitalin themeltar.
- 12.2 Çdo ortak ka të drejtë të përfaqësohet nga një person tjetër jo-ortak, i pajisur me prokurë me shkrim, me anën e së cilës mund të japë votën e tij.
- 12.3 Ortaku nuk mund të lëshojë prokurë për votim vetëm për një pjesë të kapitalit që zotëron.

Neni 13 – Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme, Kuorumi dhe Vendimet

- 13.1 Asambleja e Përgjithshme thirret të paktën një herë në vit, brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar për miratimin e pasqyrave financiare, të raportit të Administratorit/ve, dhe/ose ekspertit kontabël (nëse është emëruar) si dhe të inventarit.
- 13.2 Asambleja mund të thirret në çdo moment nga njëri prej Administratorëve me iniciativën e tij ose sipas kërkeses me shkrim që do tu drejtohet Administratorëve nga një ose disa prej ortakëve që përfaqësojnë të paktën 5% (pesë përqind) të kapitalit themeltar. Asambleja duhet të thirret nëpërmjet njoftimit me letër rekomande me kthim përgjigje, që duhet t'u dërgohet ortakëve dhe ekspertit kontabël (nëse është emëruar), të paktën 7 (shtatë) ditë përpara mbledhjes së Asamblesë. Thirrja duhet të përmbajë informacion mbi llojin e Asamblesë, mbi çështjet që do të trajtohen dhe për të cilat do të merret vendim, mbi vendin, orën dhe datën e thirrjes së parë dhe të dytë.
- 13.3 Asambleja mund të thirret edhe jashtë selisë së Shoqërisë, edhe jashtë shtetit.
- 13.4 Në rast se Asambleja e Përgjithshme nuk mblidhet me thirjen e parë për mungesën e kuoromit të parashikuar në pikën 13.7 të këtij Statuti, Asambleja e Përgjithshme do të thirret brenda 7 (shtatë) ditësh me të njëjtin rend dite.
- 13.5 Mbledhjet e Asamblesë mund të mbahen edhe nëpërmjet telekonferencës dhe videokonferencës, me kusht që të gjithë pjesëmarrësit të mund të identifikohen dhe t'u lejohet atyre të ndjekin diskutimin dhe të ndërhyjnë në momentin e trajtimit të çështjeve në rend të ditës; pasi të jenë verifikuar këto kërkesa që duhet të rezultojnë në procesverbalin e mbledhjes, Asambleja konsiderohet e mbajtur në vendin ku ndodhet Kryetari në të cilin duhet të ndodhet edhe Sekretari i mbledhjes ose noteri publik.
- 13.6 Asambleja do të thirret dhe mbahet rregullisht edhe pa respektimin e formaliteteve të njoftimit, në rast se janë të pranishëm ortakët që përfaqësojnë të tërë kapitalin themeltar dhe të gjithë ortakët deklarojnë se janë të informuar mbi rendin e ditës.
- 13.7 Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme, për të cilat kërkohet një shumicë e thjeshtë dhe/ose cilësuar, janë të vlefshme nëse janë të pranishëm, në cilëndo mbledhje, ortakët me të drejtë vote që zotërojnë më shumë se 51% (pesëdhjetë e një përqind)

të kapitalit themeltar.

- 13.8 Asambleja e Përgjithshme vendos për çdo lloj cështje me votën pro të $\frac{3}{4}$ (tre të katërtat) e ortakëve të pranishëm që zotërojnë të paktën 51% (pesëdhjetë e një përqind) të kapitalit themeltar.
- 13.9 Çdo Asamble drejtohet nga një ortak ose ndonjë person tjetër i caktuar nga vetë Asambleja. Për pasqyrimin e vendimit Asambleja emëron një Sekretar, që mund të jetë edhe jo-ortak.
- 13.10 Vendimet e Asamblesë duhet të nënshkruhen nga Kryetari i Asamblesë dhe nga Sekretari.

Neni 14 – Administrimi

- 14.1 Shoqëria administrohet nga një ose më shumë Administratorë, me kompetenca të përbashkëta ose veçmas. Në rast se nuk është parashikuar ndryshe nga Asambleja, Administratorët qëndrojnë në detyrë për një periudhë prej 3 (tre) vjet ose deri në shkarkim apo dorëheqje dhe kanë të drejtën për tu rizgjedhur.
- 14.2 Përfaqësimi ligjor i Shoqërisë i besohet Administratorit të vetëm ose Administratorëve, bashkarisht ose veç e veç. Administratori/ët mund të ushtroj/në të gjitha kompetencat konform me sa parashikohet në nenin 95 të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe në çdo rast duke respektuar kufizimet e përcaktuara në aktin e tyre të emërimit dhe/ose nga ky Statut.
- 14.3 Administratori mund të emërojë përfaqësues të posaçëm për veprime apo kategori të caktuara veprimesh.

Neni 15 – Eksperti kontabël i autorizuar

- 15.1 Në rast se kërkohet nga ligji apo vendoset nga Asambleja e Përgjithshme, kontrolli i pasqyrave financiare dhe librave kontabël të Shoqërisë mund t'i besohet një ose disa ekspertëve kontabël të autorizuar.
- 15.2 Eksperti kontabël i autorizuar mund të emërohet dhe shkarkohet sipas mënyrës së parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

KAPITULLI IV VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, SHPËRNDARJA E FITIMEVE

Neni 16 - Viti financiar dhe pasqyrat financiare vjetore

- 16.1 Viti financiar fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor të secilit vit.
- 16.2 Viti i parë financiar fillon në datën e regjistrimit të Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe përfundon më 31 dhjetor të të njëjtit vit.
- 16.3 Bilancet vjetore, inventari, raportet e Administratorit dhe ekspertit kontabël të autorizuar miratohen nga Asambleja me shumicën e kërkuar sipas nenit 13.8 të këtij Statuti.
- 16.4 Miratimi i dokumentave që lidhen me vitin financiar duhet të bëhet brenda 6 (gjashtë) muajve që nga fundi i vitit financiar.

Neni 17 – Fitimet

- 17.1 Fitimet që rezultojnë nga bilanci vjetor, u shpërndahen ortakëve në proporcion me pjesët e kapitalit themeltar të zotëruara.
- 17.2 Asambleja mund të vendosë destinimin e fitimeve në favor të rezervave të jashtëzakonshme ose për qëllime të tjera apo dhe shtyrjen e shpërndarjes së



6



meve, plotësisht ose pjesërisht, për vitet financiare të ardhshme.

KAPITULLI V SHPËRNDARJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË

Neni 18 – Prishja

- 18.1 Shoqëria priset me përfundimin e afatit të parashikuar nga Statuti, ose përpara përfundimit në rastet e parashikuara nga ligji, ose me anë të një vendimi të Asamblesë së Përgjithshme, me shumicën e kërkuar për ndryshimet në statut.
- 18.2 Shoqëria nuk priset në rast të humbjes së zotësisë për të vepruar ose falimentimit të ortakëve. Në rast të vdekjes së ortakut, do të zbatohen dispozitat ligjore.

Neni 19 – Likuidimi

- 19.1 Në rast prishje, Shoqëria duhet të likuidohet.
- 19.2 Për të administruar këtë procedurë, Asambleja emëron një ose më shumë likuidatorë, të cilët paraqesin një bilanc mbi gjendjen e shoqërisë në çastin e hapjes së procedurës së likuidimit.
- 19.3 Me përfundimin e procedurës së likuidimit, Asambleja do të vendosë mbi bilancin financiar përfundimtar, mbi punën e kryer nga likuidatori dhe mbi përfundimin e procesit të likuidimit.
- 19.4 Pas pagimit të kreditorëve dhe mbledhjes së kërkesave për arketim likuidatori do t'i shpërndajë të ardhurat përfundimtare të likuidimit ortakëve, në proporcion me pjesët e kapitalit të zotëruara prej tyre në kapitalin themeltar.

Neni 20 - Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- 20.1 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin, zbatimin dhe zgjidhjen e këtij statuti dhe aktit të themelimit, si edhe ato që mund të lindin në përgjithësi midis ortakëve (përveç atyre personale apo jashtë Shoqërisë) ose midis një apo më shumë ortakëve dhe Shoqërisë, do të zgjidhen në mënyrë miqësore dhe do të diskutohen në mënyrë të drejtpërdrejtë ndërmjet palëve të interesuara.
- 20.2 Në rast se nuk arrihet në një zgjidhje miqësore të mosmarrëveshjes, ato do t'i besohen Gjykatës Tiranë.

Neni 21 – Gjuha

- 21.1 Ky Statut është hartuar në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe me bashkëlidhur përkthimin në gjuhën italiane.
- 21.2 Për të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin e akteve dhe dokumenteve të sipërpërmendura, versioni shqip do të jetë i vetmi ligjërishit i detyrueshëm.

ORTAKET

për Shoqërinë "Eltek" S.r.l.

Andrea Blanchet
ELTEK SRL
 Përfaqësuar nga Andrea Blanchet
 Via Chiavornicco, 26
 33084 CORDENONS (PN)
 P.IVA / C.F. 01130470931

Përkthyes
[Signature]

z. Ilir Myftaraj

Ilir Myftaraj
[Signature]

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER VALBONA SH. SELIMI



DATE 04/12/2023
NR REP 7787

VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot, më datë 04.12.2023, para meje Notere VALBONA SH. SELIMI, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, në zyrën time në adresën Tirane, Rr.'Hoxha Tahsim', Godina nr.292, Kati i I-re, Tirane, u paraqiten personalisht:

NËNSHKRUESIT: Shoqëria "Eltek" S.r.l, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e se drejtes italiane me P:I: 01130470931, me seli në Cordenons (Pn), Via Chiavornicco, N.26, Itali, përfaqësuar nga Andrea Bianchet, shtetas Italian, lindur në Pordenone (PN) dhe banues në Itali, me adresë Pordenone (Pn), lindur më 04/04/1982, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Pasaporte Italiane nr. YB2286825 .

Ilir Myftaraj, atësia Myhdar, amësia Semiha, shtetas Shqiptar, lindur në Elbasan dhe banues në ELBASAN, me adresë Thoma Kalefi 00910539; Nd. 41; H. 5; Ap. 12; Elbasan; Elbasan; 3001; Elbasan, lindur më 15/02/1969, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 038561465 dhe nr. personal G90215117E.

Te cilet në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqitën dhe nënshkruan përpara meje notere:

-Akt Themelimi i Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar ILLYRIATEK Sh.p.k, date 04.12.2023;

-Statuti i Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar ILLYRIATEK Sh.p.k, date 04.12.2023;

Unë Noterja, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005, vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTERE

VALBONA SH. SELIMI

